



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

THIRRJE

**PËR PARAQITJEN E SHPREHJES SË INTERESIT PËR KANDIDATË NË KËSHILLIN E LARTË
TË PROKURORISË**

PROKURORËVE PRANË GJYKATAVE TË APELEVE

Në mbështetje të ligjit nr. 115/ 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë do të jenë 6 anëtarë prokurorë, nga të cilët: 1 anëtar nga Prokuroria e Përgjithshme; 2 anëtarë nga Prokuroritë e Apelit; dhe 3 anëtarë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.

Pas informacionit të ardhur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Nr. 6250 Prot., datë 20.09.2018, për ecurinë e procesit të rivlerësimit për prokurorët e listës prioritare, kandidatë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton se, nga kandidaturat e Prokurorive të Apeleve, vetëm 1 (një) prokuror është konfirmuar në detyrë.

Për sa më sipër, ftojme prokurorët e interesuar, që plotësojnë kriteret sipas ligjit nr. 115 /2015 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të shprehin interesin e tyre me shkrim drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, në adresën elektronike: [www. pp.gov.al](http://www.pp.gov.al) ose në adresën Postare: Rruga “Qemal Stafa”, Tiranë.

Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit të bashkëngjisin, të paktën, dokumentet e mëposhtme:

- a) jetëshkrimin e përditësuar;
- b) deklaratat individuale të prokurorëve që i kanë mbështetur, të nënshkuara rregullisht;
- c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- ç) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;

- d) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të shërbimeve të inteligjencës përpara 2 korrikut 1991;
- dh) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;
- e) informacion për të afërmit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor;
- ë) listën e personave të lidhur, sipas kuptimit të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- f) Formularin e Autoritetit për Informim mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

Afati, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së thirrjes së dytë në faqen zyrtare elektronike të Prokurorisë së Përgjithshme.

Kjo thirrje u dërgohet të gjithë prokurorëve në adresën elektronike zyrtare.

U shpall sot më datë 12. 10. 2018.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU

